

RELACION

TEKNIK

PER PROJEKT ZBATIMI PER OBJEKTIN:

**RIKONSTRUKSIONI I SHTRESAVE TE RRUGES SE FSHATIT
DRITHAS, NJESIA ADMINISTRATIVE SHUSHICE**

HYRJE

Projekt – zbatimi bashkangjitur, konsiston në zgjidhjen optimale për sistemimin e rruges se fshatit Drithas.

Behet fjale per rrugen qe lidh fshatin Drithas me aksin kryesor Risili-Beshisht. Rruga eshte ekzistuese me te gjitha nenshtresat e saj por me demtime ose mungesa ne disa pjese te shtresave asfaltike. Kjo ka ardhur si rezultat i mos mirembatjes per nje periudhe te gjate kohore.

Pergjate tyre ka kanale ekzistuese ose siperfaqe shkarkimi te ujrave siperfaqesor.

Pas studimit te gjendjes aktuale si dhe rilevimit topografik eshte ralizuar projekti nga Drejtoria e Urbanistikës se Bashkise Vlore.

Rruga paraqitet e demtuar me gropa te thella dhe mangesi te shperndara pergjate saj. Trupi i rruges eshte i shtruar me cakell dhe i konfiguruar me gjeresi dhe pendenca te pershtateshme. Qendra e fshatit perballe Kishes eshte shtruar vetem me cakell.

Ne projekt parashikohen riparimet e demtimeve si dhe shtrimin e te gjithe rruges me asfalt sebashku me vijezimet e nevojshme.

Gjeresia e rruges varion nga 4.5-5 m.



Foto te gjendjes ekzistues




Foto te gjendjes ekzistues

SHTRESAT RRUGORE

Ne funksion te trafikut, jane percaktuar shtresat rrugore per seicilin segment rrugor te cilat jane paraqitur ne profilat terthor te materialit grafik. Per kategorine e projektimit qe ka rruga, numri maksimal i mjeteve qe parashikohet te kalojne ne to eshte rreth 500-600 mjete ne dite me perpektive per 20 vjet, me rritje mesatare vjetore rreth 4 %. Per kete numer mjetesh jane percaktuar shtresat rrugore. Gjithashtu ne rruget ekzistuese do te behet plotesimi i shtresave ekzistuese me shtresa te tjera te nevojshme. Shtresat e parashikuar ne projekt jane:

Cakell per mbushjen e gropave pjeserisht.

Nivelim i gropave me cakell

Shtrese stabilizanti 10 cm

Shtrese binderi 4 cm

Shtrese asfalti 4 cm



SHPRONESIMET

Per realizimin e punimeve nuk ka nevoje per shpronesime pasi gjirra e rruges kalon ne prone shteterore

ORGANIZIMI I PUNIMEVE

Për rikonstrukcionin e rrugës është parashikuar që materialet e ndërtimit do të prodhohen me gurë kave që gjendet ne guroret e rrethit . Materiali i asfalto betonit do të vijë i gatshëm nga nyjet më të afërta në përputhje me kërkesat e projektit

Të gjitha punimet janë parashikuar të kryhen në përputhje me specifikimet teknike që i bashkëngjiten këtij projekti.

Preventivi i punimeve është dhënë për të gjithë rrugën .

Në preventiv janë parashikuar të gjithë zërat e punimeve sipas specifikimeve teknike të këtij projekti, çmimet janë marrë nga Manuali i teknike të ndërtimit, i vitit 2023.

Për të gjitha zërat e punimeve janë bërë analizat e prodhimit dhe vendosjes në vepër në përputhje me organizimin e punimeve, standartet dhe kushtet teknike në fuqi.

Bashkëngjitur këtij raporti janë dhënë; specifikimet teknike të punimeve, volumet e punimeve me vlerësimet e kostos, dhe preventivi përkatës

Në preventivin e punimeve parashikohet punime të domosdoshme për riaktivizimin dhe rikonstrukcionin të ndonjë segmenti të mundshëm që do të rezultojë i dëmtuar dhe jashtë funksionimit. Punime këto që duhet të konfirmohen mbas verifikimit nga ekipi i specializuar i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike .

Situacionimi i këtyre punimeve do të bëhen mbas verifikimit dhe matjes së punimit në proces verbalin e vecantë që do të hartohet nga drejtuesi i punimeve , kontraktori dhe drejtuesi teknik i punimeve.

Ing. Darjan HUDHRA